



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Amt für deutschsprachigen obligatorischen Unterricht
Spitalgasse 1, 1701 Freiburg

Për prindërit e shkollës gjermane të
detyrueshme

Service de l'enseignement obligatoire de langue
allemande EnOA
Amt für deutschsprachigen obligatorischen
Unterricht DOA

Spitalgasse 1, 1701 Freiburg

T +41 26 305 12 31, F +41 26 305 12 13
www.fr.ch/doa

Unser Zeichen: AM/B63F
Direkt: +41 26 305 12 30
E-Mail: Andreas.Maag.Doa@fr.ch

Fribourg, 17 prill 2020

COVID-19 : Mbyllja e shkollës dhe ndjekja e mësimeve ne distance duke filluar nga data 20 prill – mësimdhënia vazhdon !

Të dashur prindër, të dashur nxënës,

Në lidhje me vendimin e marrë dje nga Këshilli federal mësimdhënja në ambientet shkollore për shkollën e detyrueshme do të ndiqet përgjatë edhe të tre javëve të ardhshme. Mësimdhënja në presencë për shkollën e detyrueshme mund të filloj nga data 11.05.2020. Këshilli federal do marrë një vendim më datë 29.4.2020. Konkretisht, kjo do të thotë që mësimdhënja në distance do vazhdoj edhe tre javë ë tjera.

Çdo nxënës ka detyrën të ndjek mësimin në distancë që është praktikuar nga data 16 mars. Ndërkohë, mbas dy javëve pushim që kaluan, nxënësit duhet të marrin aktivitete shkollore prej 20.04.2020, domethënë të mësoj dhe të punoj në shtëpi.

Kurset do të jenë në linjë. Mësimdhënja qëndron në përgjegjësinë e shkollës dhe të mësuesve, por edhe prindërit janë njëloj të përgjegjshëm për të fiksuar një kohë të caktuar çdo ditë për fëmijët dhe ti përshtatni një vend studimi në shtëpi dhe në mënyrë që ata të studiojnë në një mënyrë autonome.

Mësuesit, mësueset FLS (gjermanisht gjuha e dytë), mësuesit e specializuar dhe specialistët e tjerë do bëjnë çdo gjë që është e mundur që mësimdhënja në distance të ndiqet në kushtet më të mira, do të thotë në funksion të kompetencave, të moshës, të autonomisë së fëmijës dhe të teknikave të mundshme. Ata sigurojnë kontaktin me çdo nxënës. Nëse fëmija ose fëmijët tuaj gjejnë vështërsi, është e rëndësishme të kontaktoni menjëherë mësuesin e klasës ose specialistë të tjerë të fëmijës tuaj.

Ju falenderojmë për mirkuptimin, për mbështetjen tuaj dhe për mirë bashkpunimin që ju keni treguar deri tani për të kaluar këtë situatë krize sanitare që neve na ka detyruar për të përshtatur një mësimdhënie në distance. Ju sillni një kontribut të rëndësishëm dhe me shumë vlerë për të përballur situatën aktuale dhe për ndjekjen e mësimdhënies së fëmijës apo fëmijëve tuaj.

Nxënësit

Nxënësit nuk janë në pushim. Ata mësojnë dhe bëjnë detyrat në shtëpi. Faktorë të dryeshëm si mosha, kompetencat, autonomia dhe kushtet familjare ndikojnë në kohën e mësimit të përditshëm. Koha e mësimit që aplikohet janë :

- > 1H - 4H: midis 30 dhe 120 minuta (koha maksimale ditore për mësimin në distancë)
- > 5H - 8H: midis 145 et 250 minuta (koha maksimale ditore për mësimin në distancë)
- > 9H - 11H: midis 240 et 270 minuta (koha maksimale ditore për mësimin në distancë)

Mësuesit dhe mësuesit e specializuar ju dërgojnë nxënësve punët dhe detyrat që duhet të bëjnë dhe janë në kontakt me mënyra të ndryshme (postë, telefon, e-mail, Internet, faqja e sitit të shkollës, etc.) Për më shumë, momente shkëmbimi, të shpërndarjes së punëve, dhe kthimit të informacioneve apo një kohë e caktuar pune individuale mund të jetë organizuar.

Nxënësit ndjekin instruksionet që ju janë dhënë nga mësuesit dhe mesuesit e specializuar dhe nga drejtimi i shkollës në mënyrë që mësimeve të jetë e garantuar.

Në mësimin në distancë nuk ka provime në formë notash apo vlersimesh.

Mësimdhënja vazhdon !

Prindër

Si prindër, ju jeni përgjegjës për ndjekjen e fëmijëve tuaj në mësimin në distance. Fëmijet duhet ti përkushtojnë kohe të nevojshme mësimeve dhe detyrave që ju janë kërkuar.

Ata duhet të ndiqen me instruksionet e mësuesve dhe mësuesve të specializuar.

Elaborimi i një plani pune dhe pausave gjithashtu argëtimit do të japin fëmijëve tuaj një siguri dhe strukturë. Vijuni rregulla fëmijëve tuaj. Nëse ju keni vështësi për këtë mund të kontaktoni mësuesit dhe mësuesit e specializuar apo nëse është e nevojshme edhe drejtorinë. Shkolla do ju dalë krah në këtë arritje të mandatit tuaj edukues të përgjithshëm.

Duhet të dini që viti shkollor 2019/20 do quhet si një vit komplet dhe pse situata është e tillë. Do ju informojmë përsëri mbi situatën dhe mbi të gjitha mbi hyrjen në shkollë mbas asaj të detyrueshme.

Mësues-e

Mësuesit dhe mësuesit e specializuar janë në dispozicionin e nxënësve dhe të prindërve sipas orarit të caktuar që ju janë komunikuar dhe dërguar më parë.

Do të gjeni një broshurë informacionesh (vetëm në gjermanisht) mbi mësimin në distance e destinuar prindërve në faqen zyrtare të shkollës.

Ju falenderoj per angazhimin në këtë situatë të jashtëzakonshme.
Ju uroj më të mirat,



Andreas Maag
Shef i shërbimit

Kopien

—

Marianne Küng-Reusser, Stv. Amtsvorsteherin DOA
Christa Aebischer-Piller, Schulinspektorin Kreis 9
Matthias Wattendorff, Schulinspektor Kreis 10
Markus Fasel, Schulinspektor Kreis 11
Schuldirektionen der Primar- und Orientierungsschulen
Lehr- und Fachpersonen der Primar- und Orientierungsschulen